



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja nr. 50
Prishtinë, më 24.06.2010 në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës
Salla nr. N- 225

P R O C E S V E R B A L

i mbledhjes së Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Arsim Rexhepi, kryetar, Drita Kadriu, Enis Kervan, Donika Kadaj –Bujupi, Ismajl Kurteshi dhe Dragan Dimiq.

Munguan Heset Cakolli, Mark Krasniqi dhe Adem Hajdaraj.

Në mbledhje prezantuan: zv.ministri i punëve të brendshme Fatmir Xhelili , përfaqësuesi i OSBE - së, NDI - së, përfaqësues nga mediat, përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit si dhe praktikantë të caktuar për Komisionin.

Nga sekretaria e Kuvendit mori pjesë Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu dhe Shaip Goxhuli

Mbledhjen e udhëhoqi: Arsim Rexhepi kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 21.06.2010
3. Raportimi i ministrit të punëve të brendshme lidhur me çështjen e trafikimit të fëmijëve, sipas Planit të Veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian

4. Shqyrtimi i shkresës së Fakultetit të Edukimit për kohëzgjatjen e moshës së pensionimit të mësimdhënësve universitarë
5. Shqyrtimi i raportit nga vizitat e Komisionit jashtë vendit
6. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 21.06.2010.

Procesverbali i mbledhjes së datës 21.06.2010 u miratua pa vërejtje.

3. Raportimi i ministrit të punëve të brendshme lidhur me çështjen e trafikimit të fëmijëve, sipas Planit të Veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian

Kryesuesi, përshëndeti zv.ministrin dhe e ftoi të raportoi lidhur me të arriturat dhe progresin në drejtim të përmbushjes së Planit të Veprimit për Integritet Evropian lidhur me çështjen e trafikimit të fëmijëve sipas Planit të Veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian.

Fatmir Xhelili zv.ministër i punëve të brendshme tha se në Institucione është bërë një punë e madhe lidhur me çështjen e trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre.

Në këtë drejtim Qeveria ka ndërmarë hapa të mëdha dhe është formuar Grupi Ndërmintor ku bartëse e këtij grupi është Ministria e Punëve të Brendshme.

Është hartuar Strategjia për luftë kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe janë përcaktuar objektivat dhe prioritetet për parandalimin dhe luftimin e personave të involvuar në trafikim.

Është hartuar plani i veprimit dhe dokumente të rëndësishme që kanë të bëjnë me procedurat standarde të veprimit për viktimat e trafikimit, si dhe janë planifikuar aktivitetet në drejtim të realizimit të objektivave të përcaktuara në Strategji.

Janë nënshkruar marrëveshje me MPB . Policisë, Gjyqësisë dhe Prokurorisë me qëllim të këmbimit të informacioneve.

Në bashkëpunim me OJQ-të si UNDP, IOM, OSBE, ICMPD është bërë shumë progres në këtë aspekt janë mbajtur trajnime të ndryshme.

Në kuadër të mbrojtjes së viktimave janë mbajtur edhe debate televizive, takime dhe diskutime të ndryshme në drejtim të sensibilizimit të opinionit për pasojat e trafikimit të fëmijëve dhe qytetarëve.

Donika Kadaj Bujupi tha se nga raportimet nuk janë shifrat reale ngase shumica e familjarëve nuk i publikojnë dhe raportojnë rastet e trafikimit të fëmijëve. Me këtë rast duhet gjetur forma dhe mënyra për tu marrë me këtë dukuri.

Ajo shtroi këto pyetje

- a ka raste kur zyrtarët e caktuar të ministrisë të janë involvuar në këtë çështje dhe a janë marrë masa ndaj tyre;

- sa Qendra strehimore janë në kuadër të Qeverisë dhe si menaxhohen ato;
- si është gjendja e trafikimit në pjesën veriore të Mitrovicës ku dyshohet se vepron një pjesë e SHIK-ut e cila inkason një shumë prej 200 milion euro në vit për këtë çështje.

Zv. Ministri Xhelili u përgjigj pyetjeve se ka pasur raste kur zyrtarët e caktuar të ministrisë janë marrë në pyetje për keqpërdorim të detyrës zyrtare.

Sa i përket Qendrave dhe Strehimoreve tha se në Kosovë ekziston Qendra për viktimat e trafikimit dhe se ka disa Strehimore në qytete të ndryshme si në Prishtinë, Prizren, Mitrovicë, Gjilan.

Sa i përket pjesës veriore të Mitrovicës në pikat kufitare 1 dhe 31 qasja në këto pika ka qenë e vështirësuar, ndërsa çështja e SHIK –ut mendon se është e mbyllur dhe të dhënat e tilla janë të pasakta.

Drita Kadriu tha se çështja e trafikimit të fëmijëve është një çështje e ndjeshme e cila ka ekzistuar edhe më herët. Raporti i MPB –së na inkurajon të japim mbështetjen tonë dhe në këtë aspekt duhet të merren aktivitete në fushën e arsimimit përmes vetëdijesimit në shkolla.

Më tej kërkon që lëndët të cilat merren më trafikim të fëmijëve të kenë prioritet në Gjykata.

Enis Kervan mendon se shifrat e dhëna nga raporti i Departamentit të SHBA –së nuk janë të sakta dhe lidhur me këtë kërkon sqarim se a ka dërgua MPB ndonjë shifër zyrtare me këtë rast.

Zv ministri Xhelili theksoi se gjatë vitit 2009 janë realizuar 80 për qind e aktiviteteve të planifikuara në Planin e veprimit

Në këtë vështrim ai tha se policia kosovare ka avancuar punën në luftimin e trafikimit, duke u pajisur në mënyrë adekuate, ndërsa është funksionalizuar edhe detabaza për viktimat e trafikimit, si dhe e autorëve të përfshirë në trafikim.

Krahas institucioneve tjera, kontribut të rëndësishëm në luftën kundër trafikimit ka dhënë edhe Ministria e Arsimit, sidomos kur është fjala për organizimin e trajnimeve të ndryshme që kanë të bëjnë me riintegrimin e viktimave në shoqëri.

Kryetari i Komisionit tha se raporti i Departamentit të SHBA nuk ka qenë real pasi që shifrat e dërguara janë marrë nga OJQ-të ndryshme dhe nuk kanë qenë zyrtare.

Komisioni do të përgatisë raport të cilin do ta dërgon Komisionit për Integritet Evropian për fushën të cilën kërkohet nga raporti i Planit të veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian.

4. Shqyrtimi i shkresës së Fakultetit të Edukimit për kohëzgjatjen e moshës së pensionimit të mësimit në universitet.

Kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për mbledhjen e radhës të Komisionit.

5. Shqyrtimi i raportit nga vizitat e Komisionit jashtë vendit

Raporti nga vizitat e Komisionit jashtë vendit do të diskutohen në mbledhjen e ardhshme pasi që në këtë takim mungojnë tre anëtarë të Komisionit.

Anëtari i Komisionit Ismail Kurteshi paraqiti para anëtarëve raportin nga vizita e tij në Danimarkë dhe kërkoi që edhe ky raport të diskutohet në mbledhjen e radhës.

6. Të ndryshme.

Enis Kervan, foli për ngecjet që janë bërë nga ministria e arsimit për tekstet shkollore në gjuhën turke, si dhe për të metat e testit të maturës në gjuhën turke.

Komisioni konstatoi se me datë 07.07.2010 të mbahet dëgjim publik lidhur me çështjet e Trashëgimisë Kulturore në Kosovë.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 12: 30

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Arsim Rexhepi